



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2018:061362

Datë: 21.02.2020

Numri i dokumentit: 00846819

**P.nr.443/2018**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA NË SUHAREKE**, gjyqtari i vetëm gjykues Lavdim Bajraktari, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit V. Sh. nga fshati B. komuna e Vushtrisë, për shkak të vepres penale vjedhja në tentativë nga neni 325 parag. 1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II nr. 2463-2/18 të dt. 04.10.2018, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II 2463-2/18 të dt. 04.10.2018 për dhënien e urdhërit ndëshkimor pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit kryesor me dt. 21.02.2020, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr. 2463-2/18 të dt. 04.10.2018 Andaj gjykata konform dispozitave të nenit 495 të KPPRK-së jep këtë :

### **URDHËR NDËSHKIMOR**

Kundër të akuzuarit:

V. Sh. nga i ati Sh. i lindur me dt. 05.12.19879 në M., me vendbanim në rr. Sh. G.” p.n. fshati B. komuna Vushtri me numër personal ....., i pa punë, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse me dt. 19.09.2018 rreth ores 19:00 në Suharekë në Qendrën Tregtare “...” tenton personit tjetër t’ia merr pasurinë me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, në atë mënyrë që shkon në Qendrën Tregtare ... në Suharekë, shfrytëzon momentin e volitshëm dhe nga këndi i tekstitit merr nje bluzë për meshkuj dhe një fustan për vajza ku më pas duke dal jashtë ndalohet nga puntori i sigurimit të kësaj Qendre.

**-më ketë ka kryer veprën penale vjedhja në tentativë nga neni 325 parag. 1 te lidhur me neni 28 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform dispozitave të nenit 4,7,41,46, 325 parag.1 lidhur me nenin 28 të të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082 dhe nenit 365,450 463 ,dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-123, të akuzuarit i shqipton:

## **DËNIM ME GJOBË**

Të akuzuarit V. Sh. i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë **prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro)** të cilin dënim është e obliguar t'a paguaj në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në çoftëse se i akuzuari nuk mund paguaj ose nuk dëshiron t'a paguaj dënimin me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg në kohëzgjatje **prej 7 (shtatë)** ditësh, duke i caktuar të akuzuarit për çdo 20 € (njëzetë euro), të dënimit me gjobë për 1 (një) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzete euro), si dhe në emër të taksës për viktimat e krimit në shumën prej 30 € (tridhjetë euro), pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcnim të përmbarimit të detyrueshëm ligjor.

I dëmtuari Qendra Tregtare ... në Suharek, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren ndaj të akuzuarit V. Sh., ka parashtruar aktakuzë PP.II.nr. 2463-2/18 të dt. 04.10.2018 për shkak të veprës penale vjedhja në tentativë nga neni 325 parag. 1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082, dhe së bashku me aktakuzën ka kërkuar që për të akuzuarin të jepet urdhëri ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallzimi penal lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet dhe në kuptim të nenit 495 te KPP-së, të ipet urdhër ndëshkimor, dhe ti shqiptohet denimi me gjobë sipas ligjit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor pranë kësaj gjykate.

Gjyqtari individual me rastin e shqyrtimit paraprak të çështje konform nenit 494 të KPPRK ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet nga neni 493 te KPPRK-së dhe konform nenit 495 paragraf 1,2 dhe 3 të KPPRK-së vendosi që ta pranoj kërkesën për dhënin e urdhërit ndëshkimor dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim me gjobë si në dispozitiv aktgjykimit.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës sië janë: raporti fillestar i incidentit, dt 19.09.2018, raporti i oficerit me nr 2018-GB-... të dt. 20.09.2018, deklaratën e dëshmitarit B. G. të dt 20.09.2018, deklarata e të akuzuarit V. Sh. edt. 19.09.2018 e dhënë në stacionin policor në Suharekë, fatura e QT. "...” ne Suharekë me ate ciles vërtohet se i njejt ka pagur sendet që ka tentuar ti vjedhë, CD-ja me incizimet për vjedhjen në tentativë nga i akuzuari, si dhe foto dokumentacioni në shkresat e lëndës, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i akuzuari është kryers të veprës penale vjedhja në tentativë nga neni 325 parag. 1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082 pasi në veprimet e tij formohen elementet e veprës penale vjedhje sepse me dashje ka ndërmarrë veprim e kundërligjshëm me qëllim që vetit apo personit tjetër t'i sjell dobi pasurore, por e cila ka mbetur

në tentativë pra vjedhja nuk është kryer nga i akuzuari pasi që është hasur nga punëtori i sigurimit kështu kjo veprë dënohet edhe për tentativë sipas nenit 28 par. 1 të KPK-së.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndes, përmbushën elementët e figurë së veprës penale vjedhja e mbetur në tentativë nga neni 325 parag.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-se dhe vërtetohet se i akuzuari është kryes i veprës për të cilën edhe akuzohet, dhe për të cilën i'u shqiptua dënimi sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale dhe paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 453 të KPP-së, ndërsa taksën për viktimat e krimit gjykata e bazoi në nenin 39 të parag.3 të ligjit mbi kompenzimin e viktimave të krimit nr. 05/L-036.

Vendimin që e dëmtuara lidhur me kërkesën pasurore juridike për kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale të udhëzoj në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 463 parag.2 të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kësaj kërkesë.

Më sa u tha me lartë në kuptim të nenit 495 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA NË SUHAREKË**  
**Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal**  
**P.nr. 443/2018 të dt. 21.02.2020**

**G j y q t a r i**  
Lavdim Bajraktari

---

**KESHILLE JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit, në këte gjykatë, poqese i akuzuari nuk ushtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor aktgjykimi merrë formën e prerë.